

EKONOMITË E RAJONIT

Selami Xhepa
Diana Shtylla*

Fjalë kyçe

- Maqedonia - Situata makroekonomike - Banka Kombëtare e Maqedonisë
- Kosova - Ekonomia kosovare -

Ditët e fundit në Shqipëri u bë temë e ditës realizimi i marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet e rajonit. Pa u përpjekur për të analizuar anët pozitive apo negative të këtij procesi, një gjë është e qartë: zbatimi i këtyre marrëveshjeve do të çojë në rritjen e integritit ekonomik të rajonit. Përveç përfitimeve, integrimi rrit edhe rrezikun e transmetimit të problemeve ekonomike apo politike të një ose disa vendeve të rajonit në ekonominë shqiptare. Po ashtu, integrimi krijon hapësira dhe tregje të reja “për t’u pushtuar” nga biznesmenët shqiptarë. Ky proces bën të nevojshme ndjekjen me kujdes të zhvillimeve në ekonomitë e rajonit.

Materiali në vazhdim analizon efektet e mundshme të krizës në FYROM në ekonominë shqiptare si dhe hapësirat që ofron Kosova.

KRIZA NË MAQEDONI

1. SFONDI I NGJARJEVE

Kriza në vendin fqinj, Maqedoni, filloi në fund të muajit shkurt 2001 dhe vazhdon akoma. Zgjidhja e krizës politike në këtë vend duket akoma shumë e paqartë. Komuniteti ndërkombëtar, krahas mbështetjes që i jep Qeverisë Maqedonase, po i kërkon gjithnjë

e më shumë gjetjen e zgjidhjeve politike të krizës, duke vendosur dialog me faktorin shqiptar. Ky ka qenë thelbi i të gjitha mesazheve të përcjella gjatë vizitave të shpeshta të zyrtarëve të lartë evropianë dhe amerikanë në këtë vend si dhe i takimit të nivelit të lartë të BE-së në Gotenburg. Megjithatë, deri tani duket se të dy komunitetet etnike vazhdojnë të thellojnë përçarjen e tyre.

Zhvillimet në Maqedoni kanë mbetur në kuadrin e një krize të brendshme politike, pa shkaktuar ndonjë tronditje ekonomike as të vetë Maqedonisë¹.

2. SITUATA MAKROEKONOMIKE NË MAQEDONI DHE PARASHIKIMET PËR VITIN NË VAZHDIM

Sipas raporteve zyrtare², gjatë vitit 2000, Maqedonia shënoi përparim në fushën e stabilitetit të çmimeve. I matur me indeksin e kostos së jetesës (siç është rënë dakord në marrëveshjen e Maqedonisë me FMN-në), inflacioni shënoi një normë vjetore prej 0.1 për qind. Megjithëse ky tregues ishte më i lartë se vitet e kaluara, efekti i tij erdhi kryesisht nga:

- futja e TVSH-së (efekti i së cilës jepet një herë);
- rritja e çmimeve të naftës (Maqedonia është importuese neto e burimeve energjitike);
- rritja e çmimeve të kontrolluara nga shteti (të shërbimeve publike).

Por, konsiderohet sukses arritja e stabilitetit të çmimeve në sensin që faktorët thelbësorë që gjenerojnë inflacion, si: politika monetare, politikat fiskale dhe kurset e këmbimit, dhe formimi i pagave, kanë qenë nën kontroll. Për vitin 2001, norma e inflacionit është parashikuar të jetë në 1.2 për qind.

Politika monetare e Bankës Kombëtare të Maqedonisë (BKM) ka si ankorë ruajtjen e stabilitetit të monedhës kombëtare, në raportin *target* prej 31 dinarë për 1 markë gjermane. Ruajtja e këtij niveli të këmbimit është vënë si objektiv dhe për vitin në vazhdim. Rezervat valutore të saj në fund të vitit 2000 arritën

në 713.6 milionë dollarë amerikanë (me një rritje prej 235.5 milionë dollarësh vetëm gjatë vitit që shkoi).

Si rrjedhojë e heqjes së kufizimeve në kredidhënie të bankave tregtare, raportohet një rritje e ndjeshme e aktivitetit kreditues të sektorit joqeveritar (prej 27.8 për qind – krediti në dinar). Me heqjen e kufizimeve në kredidhënie, edhe Banka Kombëtare e Maqedonisë kaloi gjatë vitit që shkoi, në përdorimin e vetëm të instrumenteve indirekte në realizimin e politikës së saj monetare.

Borxhi i jashtëm (sipas disbursimeve), deri në 30 shtator 2000, arriti në 1,400.8 milionë dollarë ndërsa borxhi afatshkurtër i sektorit privat arriti në 42.9 milionë dollarë. Borxhi i jashtëm llogaritet të zërë 42 për qind të PBB-së (vend me një nivel borxhi të moderuar deri në mesatar).

3. KRIZA DHE EKONOMIA

Deri tani nuk ka asnjë evidencë se kriza politike dhe operacionet ushtarake të kenë shkaktuar ndonjë prishje të ekuilibrave ekonomike në vend. Maqedonia vazhdon të jetë e përfshirë në programet ekonomike të FMN-së që pritet të transformohen në dokumentin e Strategjisë së Rritjes Ekonomike dhe Reduktimit të Varfërisë.

Mund të mendohet që kriza të japë efekte në vonesat në realizimin e reformave strukturore, si konsolidimin e sistemit bankar (shkrirjen e bankave të vogla lokale), mbylljen e njësisë ekonomike që gjenerojnë humbje (të planifikuara të mbyllen 4 të tilla për këtë vit, nga lista prej 40 ndërmarrjesh të tilla që duhet të mbyllen gjatë programit me FMN-në.). Vlerësohet se rreth 1 miliard marka gjermane kursime të popullsisë, të mos jenë të kanalizuar në sistemin bankar³. Nga ana tjetër, shkalla e zëvendësimit monetar në këtë vend⁴ është ndër më të lartat.

Për rrjedhojë, nuk mendojmë se mund të ndodhin tronditje të rëndësishme në politikat monetare, të paktën për momentin kur po flasim (kursi i këmbimit të monedhës së vendit ndaj markës

gjermane është brenda objektivit vjetor të përcaktuar nga BKM). Deri tani nuk duket të jetë e mundur që operacionet ushtarake të japin efekte të konsiderueshme në financat e Maqedonisë.

Raportet e shtypit kanë cituar deklarata të Ministrit të Financave se Maqedonia disponon mjetet monetare⁵ për blerjen e armatimeve të reja, ndërkohë që është tashmë një fakt i njohur nga media se mjaft armatime janë dhënë falas nga vende të tilla si Ukraina, Bullgaria dhe Greqia.

Ndihmat e huaja⁶ për Maqedoninë deri tani të deklaruara pritet të jenë në 17 milionë dollarë amerikanë, në ndihma ushtarake dhe rreth 38 milionë, në financime për ekonominë. Financime të tjera pritet të jepen dhe në kuadrin e Marrëveshjes së Asociim Stabilizimit me BE-në, të nënshkruar në 9 prill 2001.

4. LIDHJET EKONOMIKE E SOCIALE SHQIPËRI- MAQEDONI

Lidhur me kanalet e përhapjes së krizave nga një vend në një tjetër, literatura evidenton si më thelbësoret dy të tilla: lidhjet tregtare dhe lidhjet financiare.

Tradicionalisht, gjatë gjithë dekadës së tranzicionit, lidhjet ekonomike dhe tregtare midis dy vendeve kanë ruajtur nivele mjaft të ulëta, që mund të konsiderohen të neglizhueshme. Pesha e tregut maqedonas ka zënë mesatarisht (për vitet 1994-1999 – shih tabelën 1) 2 për qind të importeve dhe 2.7 për qind të eksporteve, me një tendencë vazhdimisht në rënie. Nga kjo pikëpamje, nuk mund të mendohet ndonjë influencë e rëndësishme.

Tabelë 1. Tregtia e jashtme e Shqipërisë me Maqedoninë (në milionë usd).

Vitet	Import	Ekспорт	Total importi	Total eksporti	Raporti ndaj totalit, në %	
					Importe	Eksporte
1994	14.5	6.6	601	141.4	2.4	4.7
1995	16.5	8.0	679.8	204.8	2.4	3.9
1996	19.5	5.6	922	243.7	2.1	2.3
1997	13.2	3.8	693.5	158.6	1.9	2.4
1998	11.3	3.1	811.7	208	1.4	1.5
1999	17.4	4.2	937.9	275.1	1.9	1.5
Mesatare					2.0	2.7

Nga ana tjetër, nuk ekziston asnjë lidhje financiare mes dy vendeve. Nuk kemi marrëdhënie detyrimesh financiare reciproke mes nesh, të tilla që do të ndikoheshin nga ndonjë ndryshim në normat e interesave apo në kurset e këmbimeve. Nuk ka asnjë evidencë që kursime individuale shqiptare të jenë vendosur në letrat me vlerë në Bursën e Shkupit që, gjithashtu, do të ishin të ndikueshme nga ndryshimet e kushteve të brendshme ekonomike e monetare.

Një lidhje mund të evidentohet të ekzistojë në fushën e shërbimeve, kryesisht në tranzitim të mallrave drejt Kosovës. Sipas bisedave me specialistë të doganave, ditët e mbylljes së kufirit Maqedoni-Kosovë, është rritur fluksi i tranzitimeve nëpërmjet vendit tonë, që mund të ketë ndikuar në një shtim të të ardhurave buxhetore nga ky faktor. Megjithatë, shkalla e veprimit të tij është, gjithashtu, e papërfillshme. Mbyllja e kufirit veptoi për një interval kohe të shkurtër dhe aktualisht ai është rihapur. Për më tepër, mbyllja e kufirit mund të ketë rezultuar në një rritje të evazionit fiskal në vendin tonë, nëpërmjet mashtrimeve të tranzitimit, ndërsa mallrat mund të kenë qëndruar në Shqipëri, duke iu shmangur pagimit të detyrimeve tatimore⁷.

Një tjetër ndikim i mundshëm në financat tona publike do të ishte përballimi i një emigrimi të popullsisë shqiptare nga Maqedonia drejt vendit tonë. Edhe në këtë rast, nuk është evidentuar asnjë zhvillim për t'u konsideruar. Një numër i vogël emigrantësh që kaluan nëpërmjet kufirit shqiptar, kanë qenë në tranzit duke patur si destinacion vende të tilla si Kosova dhe Turqia. Mendojmë se dhe në rast të një përkeqësimi më të madh të situatës në Maqedoni (në rastin e skenarit më pesimist), barra buxhetore që do të nevojitej për mbajtjen e një numri më të madh emigrantësh do të ishte jo në përmasa të papërballueshme, duke parë preferencat e tyre për të emigruar kryesisht në vendet ku ata kanë të afërmit e tyre (Kosovë, Turqi apo vende të tjera perëndimore).

Nga të gjitha evidencat, nuk mund të evidentohet ndonjë paralele me krizën kosovare.

VËSHTRIM MBI KOSOVËN

NATYRA DHE POZITA GJEOGRAFIKE

Kosova ka një sipërfaqe prej 10,877 km², popullsi prej 2.3 milionë banorësh dhe shtrihet në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik. Krahas pozitës së favorshme gjeografike, Kosova zotëron burime të rëndësishme mbi dhe nëntokësore, klimë, florë dhe faunë të përshtatshme dhe të shumëllojshme. Burimi kryesor natyror i Kosovës është toka e punueshme. Ndër pasuritë ujore vlejné të përmenden burimet termale ndërsa si burim energjie shfrytëzohen rezervat e qymyrgurit, të cilat vlerësohen në nivelin 11.5 miliardë ton. Kosova është mjaft e pasur në metale me ngjyrë si boksiti, xehe plumbi, zinku dhe nikeli.

EKONOMIA PARA KONFLIKTIT

Në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova përfaqësonte një ekonomi kryesisht bujqësore në kuadrin e Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë. Transformimi ekonomik që u bë nën strukturën e planifikimit qendror, solli industrializimin dhe zhvillimin e industrisë nxjerrëse. Gjatë viteve '70-'80, falë financimit nga një fond kombëtar investimesh, aktiviteti ekonomik i Kosovës u zgjerua dhe u zhvillua kryesisht në drejtim të industrisë nxjerrëse, prodhimit të lëndëve të para dhe produkteve gjysmë të gatshme (çelik, qymyr, zink dhe tekstile) por bujqësia vazhdoi të mbetej e rëndësishme. Mesi i viteve '90 solli një përkeqësim të gjendjes ekonomike, që erdhi si pasojë e keqadministrimit të burimeve.

Gjatë kësaj periudhe, investimi në sektorët më fitimprurës të ekonomisë u tkurr në masë të konsiderueshme dhe papunësia arriti shifra të larta. Sektori industrial ishte shtetëror ose në pronësi shoqërore (me ndërmarrje të zotëruara nga punëtorët) dhe bankat kreditonin nisur nga motive politike. Diskriminimi etnik shfaqej edhe në ekonomi ku të punësuarit në sektorin industrial, sidomos në pozicionet kyçe, i përkisnin etnisë serbe, ndërsa popullsia shqiptare ishte e detyruar të angazhohej me

ekonominë joformale, me bujqësi apo të emigronte. Gjatë kësaj periudhe u krijuan edhe sistemet paralele të arsimimit, të shëndetësisë apo të përfitimeve sociale, të financuara prej dërgesave të diasporës kosovare dhe një sistemi taksimi paralel.

EKONOMIA AKTUALE

Ekonomia kosovare duket se po bën përpjekje për të dalë nga gjendja e krijuar në dy dekadat e mëparshme dhe për t'u përballur me pasojat e rënda që la pas konflikti i vitit 1999. Mbështetjen kryesore kjo ekonomi e ka gjetur në sipërmarrjet vendase, të cilat janë ndihmuar dhe po ndihmohen fuqimisht nga donatorë të huaj.

Asistenca e donatorëve së bashku me kursimet vendase dhe fluksin e fondeve nga diaspora, po mbajnë aktualisht barrën e rimëkëmbjes së ekonomisë së Kosovës. Këto fonde, me përfundimin e konfliktit, u mobilizuan për të riaktivizuar sektorin bujqësor apo për të filluar riparimin e shtëpive, të rrjetit ujësjellës dhe të atij elektrik. Për të siguruar qëndrueshmërinë e çmimeve dhe në mungesë të një monedhe të vendit, u vendos që të legalizohej përdorimi i markës gjermane. Paralelisht është ofruar asistencë për krijimin e një sistemi pagesash dhe bankar. Deri në gjysmën e parë të vitit 2000 mendohet që bujqësia ka arritur rreth 75 për qind të nivelit të paraluftës. Aktiviteti me më gjallëri paraqitet ndërtimi i ndjekur nga disa shërbime private si restorante, hotele apo dyqane. Tregtia e jashtme dominohet nga importet, që përfaqësojnë 85 për qind të PBB-së. Siç shihet nga tabela e mëposhtme, PBB për frymë vlerësohet në nivelin 750 dollarë amerikanë ndërkohë që shpenzimet për frymë kapin nivelin 1,125 dollarë amerikanë.

Diferenca e madhe ndërmjet të ardhurave dhe konsumit për frymë plotësohet nga dërgesat e emigrantëve kosovarë, të cilat për vitin 2000 kanë arritur deri në 40 për qind të PBB-së. Kjo sasi është rreth 1.3 herë më e lartë nga shuma e dërgesave të emigrantëve në Shqipëri, për të njëjtin vit.

Tabela e mëposhtme paraqet nivelet e disa treguesve të rëndësishëm makroekonomikë për Kosovën dhe Shqipërinë, gjatë vitit 2000. Veçanërisht të larta për të dyja vendet janë shifrat e importit.

Tabelë 2. Nivelet e treguesve makroekonomikë për Kosovën dhe Shqipërinë, gjatë vitit 2000.

Tregues makroekonomikë	Shqipëria (2000)	Kosova (2000)
PBB	3,734 mil usd	1,421 mil usd
PBB/frymë	1,131 usd	750 usd
Bilanci fiskal	- 399 mil usd *	-103.7 mil usd
Bilanci tregtar	-814.3 mil usd	-1,203 mil usd
Importi	1070.1 mil usd	1,203 mil usd
Eksporti	255.8 mil usd	--
Llogaria korente	-151.8 mil usd	-487 mil usd
Transfertat private	438.6 mil usd	569 mil usd
Transfertat shtetërore	94.4 mil usd	147.8 mil usd

Shënim: Viti 1999, në mungesë të të dhënave për vitin 2000.

GJENDJA E INVESTIMEVE AKTUALE DHE MUNDËSITË PËR INVESTIME NË KOSOVË

Ekonomia e Kosovës, me gjithë vëmendjen që po i kushtohet nga autoritetet ndërkombëtare, po kalon një fazë të vështirë. Kjo ekonomi, momentalisht, vuan nga mungesa e investimeve të huaja dhe të brendshme. Si shkaqe për mungesën e investimeve të huaja në Kosovë renditen tranzicioni i vështirë, mungesa e ligjeve dhe rreziku i shpërthimit të vatrave të tjera të konfliktit në zonën përreth. Shpeshherë mediat e huaja bëjnë pasqyrime jorealiste të situatës në vend, gjë që paralizon dëshirën apo iniciativën e investitorëve për t'u futur në tregun kosovar. Ndërhyrja e firmës "Alcatel" në rrjetin e telefonisë fikse të Kosovës u mirëprit nga opinioni shqiptar, duke ngjallur shpresën për mbërritjen e gjigantëve të huaj në ekonominë që, për momentin, duket se është lënë në hije.

Përsa i përket investimeve të biznesmenëve nga Shqipëria në Kosovë, këto janë ende të kufizuara në fushën e biznesit të vogël të restoranteve, të picerive dhe të aktivitetit tregtar. Investitorët nga Shqipëria janë ende të pasigurt për të shtrirë aktivitetin e tyre në sferën e industrisë. Këta investitorë hasin, gjithashtu, njëfarë rezistence nga tregu kosovar, i cili preferon mallrat e lirë lindorë ndaj mallrave më të shtrenjtë që vijnë nga Shqipëria.

Përmbledhja që vijon bën një paraqitje të sektorëve të ekonomisë së Kosovës, ku shfaqen mundësi për gjenerimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME), sipas një studimi të kryer në vitin 1998. Megjithëse studimi i takon periudhës para shpërthimit të konfliktit në ish-Jugosllavi supozohet se, gjatë dy viteve të fundit, zhvillimet në këto drejtime kanë qenë shumë të pakta ose inekzistente. Për këtë arsye, vlerësohet se ekonomia kosovare ka ende nevojë për rimëkëmbjen dhe shfrytëzimin e këtyre mundësive që kanë shumë për të ofruar. Momentalisht në Kosovë vepron Njësia e Përkohshme Kredituese e themeluar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim (EAR), e cila synon të ndihmojë SME-të. Fondacione të tjera kredituese për mbështetjen e projekteve pilot janë siguruar nga Banka Botërore, EAR dhe BERZH. Në vijim paraqiten sektorët e ekonomisë, që mendohet se paraqesin interes për investime.

AGROBIZNESI

Nga studimi i kryer, në rend të parë vendoset aktiviteti i agrobiznesit. Nevoja për produkte ushqimore është theksuar sidomos pas situatës së krijuar në vitin 1999, gjë që shprehet në nivelin e lartë të importeve të këtyre produkteve në Kosovë. Për shkak të zhvillimit të ekonomisë familjare dhe të ekzistencës së sipërfaqeve të vogla bujqësore, ferma bujqësore konsiderohet si bartëse e aktivitetit të agrobiznesit. Është vlerësuar se, nëpërmjet investimeve të përbashkëta ose investimeve që vijnë tërësisht nga diaspora, mund të realizohen programe me vlerë nga 8,000 deri në 100,000 dollarë amerikanë (apo më tepër), të cilat japin norma fitimi të nivelit deri në 30 për qind, ndërkohë që investimi fillestar mund të shlyhet brenda 2-3 vjetëve. Në vijim paraqiten disa ndër programet që janë parë të përshtatshme për investime: përpunimi i produkteve të qumështit; prodhimi i produkteve të brumit; konservimi dhe përpunimi i frutave dhe i perimeve; minihertoret dhe përpunimi i mishit; minibirraritë; fermat e majmërisë së gjedhëve, pulave, deleve, dhive, derrave, shpezëve të egra etj.; prodhimi dhe përpunimi i mjaltit; paketimi i produkteve ushqimore etj.. Nga vlerësimi i mundësive që i hapen Kosovës së pasluftës, rezulton se ky vend mund të kthehet

në një eksportues të mallrave të agrobiznesit/ përpunimeve bujqësore në vendet e Bashkimit Evropian në të ardhmen.

INDUSTRIA

Industria ose prodhimtaria paraqet një spektër të gjerë të veprimtarive në Kosovë dhe llogaritet se punëson mbi 20 për qind të popullsisë kosovare. I përbërë nga ndërmarrjet shoqërore dhe private, ky sektor duket se punon me kapacitete të vogla. Për zhvillimin e këtij sektori të ekonomisë Departamenti për Tregti dhe Industri pranë UNMIK-ut, gjatë vitit 2000, ka shpallur 10 tendera për ndërmarrjet.

Industria mund të trajtohet sipas tre linjave kryesore: industria përpunuese, industria e përpunimit të metaleve dhe industria tradicionale.

- a. Të dhënat për zhvillimin e deritanishëm të *industrisë përpunuese* në Kosovë dhe krahasimi i tyre me të dhënat përkatëse të vendeve më të zhvilluara, tregojnë se Kosova është karakterizuar nga një shkallë e ulët e industrisë përpunuese. Deri në fillim të viteve '90 në Kosovë janë prodhuar ose ka patur mundësi të prodhohen kryesisht plehurat kimike, pijet alkolike dhe joalkolike, çimentoja, disa produkte metalurgjike dhe disa produkte të gomës, produkte këto që kanë përmbushur pjesërisht kërkesat për eksporte. Megjithëse fillimisht industria përpunuese është parë si industri e kapaciteteve të mëdha, ajo ka nisur të perceptohet si industri që mund të zhvillohet nga kapacitetet e vogla dhe të mesme, në përputhje me zhvillimet teknike dhe teknologjike që kanë ndodhur në botë. Përveçse në sferën e produkteve të lartpërmendura, të cilat nuk prodhohen më, industria përpunuese ka nevojë të zgjerohet me produkte të tilla si kimikatet; barnat dhe lëndët e para farmaceutike; yndyrnat dhe vajrat; ngjyrat, llaqet dhe pigmentet e tjera; prodhimet e rafinimit të naftës dhe të përpunimit të drurit; materialet plastike dhe gomat; druri, celuloza dhe kartoni etj., të cilat aktualisht

sigurohen nga eksporti.

- b. *Industria e përpunimit të metaleve* duhet të mbështetet në stimulimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të cilat shfrytëzojnë përparësitë krahasuese të sigurimit vetjak të lëndës së parë si edhe eksperiencën e grumbulluar gjatë shumë viteve në këtë fushë. Kosova është kryesisht e pasur në plumb, zink, kadmium, bizmut, argjend, ferronikel etj..

Duke ditur se prodhuesit e mëdhenj të Evropës shtrojnë kërkesa të larta për produkte finale apo gjysmë të gatshme të kësaj industrie, mendohet se industria e Kosovës, në të ardhmen, mund të synojë të realizojë plotësimin e këtyre kërkesave, krahas përmbushjes së pjesshme apo të plotë të nevojave të vendit për këto produkte.

Gjendja e infrastrukturës industriale të Kosovës, në të shkuarën, ka qenë e kënaqshme, ndërkohë që, aktualisht, po synohet t'i jepet përparësi rehabilitimit dhe rigjenerimit të kësaj infrastrukture, e cila rreshti së shfrytëzuar gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme shihen si njësi të cilat, me fillimin e punës në industrinë nxjerrëse, me investime të vogla dhe fuqi të kufizuar punëtore, mund të shfrytëzojnë metalet e lartpërmendura për prodhimin e gjysmëprodukteve dhe produkteve finale. Kusht elementar që duhet plotësuar për një prodhim fillestar nga plumbi, zinku, bismuti dhe kadmiumi është instalimi i një furre të vogël elektroinduktive me kapacitet deri në 20 kw. Është e vetëkuptueshme që çdo ndërmarrje, që ka të bëjë me përpunimin e lëndëve minerale, duhet të veprojë sipas rregullave për mbrojtjen e ambientit.

- c. *Industria tradicionale* e Kosovës mendohet se do të mbështetet në prodhimin e sapunëve dhe të detergjenteve; prodhimin e letrës për ambalazhim; industrinë e qelqit, të porcelanit dhe të qeramikës; në medikamentet farmaceutike etj.. Një theks i veçantë duhet vënë në rigjenerimin e industrive tradicionale të Kosovës si tekstili, përpunimi i drurit dhe industria e materialit ndërtimor, të cilat në të kaluarën kanë siguruar produkte të cilësisë së lartë.

NDËRTIMTARIA

Gjatë viteve të fundit, ndërtimtaria në Kosovë ka marrë një rëndësi të veçantë duke qenë se nevojat për rindërtimin e shtëpive dhe ndërtesave të shkatërruara apo të lëna pas dore gjatë luftës, kanë qenë të mëdha.

Deri në fund të vitit 2000, vlerësohet se investimet për rindërtim arrijnë në gjysmë miliardi dollarë ndërkohë që, sipas vlerësimit të Agjencisë Evropiane për Rindërtim, kërkesa për materiale ndërtimi do të vazhdojë të rritet edhe për disa vite të ardhshme në Kosovë.

Kontributi i Shqipërisë në procesin e rindërtimit të Kosovës është materializuar në eksportet masive të lëndës drusore, të siguruar nga pyjet në veri të Shqipërisë. Firmat apo shoqëritë ndërtimore nga Shqipëria, duke mos u ndjerë të sigurta, nuk i janë afruar Kosovës, me gjithë urinë e madhe që ka vendi për zhvillimin e këtij aktiviteti. Aktualisht, në Kosovë veprojnë 34 ndërmarrje shoqërore dhe rreth 95 ndërmarrje private, të cilat merren kryesisht me prodhimin e tjegullave, të tullave, të çimentos dhe të gëlqeres, si edhe me përpunimin e drurit për mobilje, dyer, dritare etj..

Sipas studimit të lartpërmendur, ndërmarrjet e vogla ndërtimore në Kosovë mund të grupohen në tre lloje të ndryshme të strukturave. Tipi i parë janë ndërmarrjet që në portofolin e tyre kanë prodhimin e materialit ndërtimor, si edhe tregtinë dhe projektimin e materialeve. Tipi i dytë i firmave të mesme janë ndërmarrjet private që ushtrojnë aktivitet ndërtimor. Këto firma, nëse arrijnë efikasitetin e duhur, mund të çojnë në rritjen e kapaciteteve.

Tipi i tretë i ndërmarrjeve të mesme mendohet se do të krijohet nga privatizimi dhe nga ristrukturimi i ndërmarrjeve të sotme shoqërore/shtetërore. Aktiviteti i këtyre tre lloj ndërmarrjesh mendohet se do të kontribuojë kryesisht në rindërtimin e Kosovës së pasluftës dhe do të shtrihet në linjat e mëposhtme: ekzekutim i punimeve të zakonshme ku bëjnë pjesë ndërtimtaria e lartë

dhe ajo e ulët, punët zejtare dhe mirëmbajtja e objekteve; dhe ekzekutim i punimeve të specializuara (fundimet-gjeoteknika, montimi, izolimet, rrënimet, minimet etj.).

KOMUNIKACIONI

Zhvillimi i komunikacionit në Kosovë merr një rëndësi të veçantë, duke pasur parasysh çrregullimet që kanë rezultuar natyrshëm pas situatës së krijuar në vitin 1999. Lëvizjet e mëdha të popullsisë nga brenda jashtë Kosovës dhe në drejtim të kundërt, transporti i mallrave dhe hyrja masive e administratës së huaj janë dukuri që e bëjnë të domosdoshëm krijimin e një rrjeti efektiv të komunikacionit rrugor, hekurudhor, ajror dhe atij të PTT-së dhe RTV-së. SME-të e komunikacionit pritet që të realizojnë transportin e mallrave dhe të udhëtarëve, mirëmbajtjen e infrastrukturës së trafikut dhe mjeteve të transportit etj..

TURIZMI

Pasuritë natyrore e kulturore të Kosovës paraqesin burime turistike me vlerë. Kosova disponon kushte të volitshme për zhvillimin e turizmit dimëror-malor, të banjave mjekuese, të gjuetisë, të peshkimit sportiv dhe të sporteve të ujit. Ndonëse aktiviteti i turizmit, momentalisht, është lënë mënjanë, ai mund të shihet si burim të ardhurash në një të ardhme jo shumë të largët. Në lëmin e turizmit, përparësi merr: rigjallërimi i objekteve ekzistuese si edhe ndërtimi i objekteve të reja të destinuara për turizëm masiv (kryesisht në lokalitetet e Brezovicës dhe të Deçanit), afirmimi i turizmit në sportet e gjuetisë dhe të peshkimit, zgjerimi i objekteve hoteliere me qendra sportive, rikonceptimi i kompleksit "Boro e Ramiz" në Prishtinë, me qëllim krijimin e mundësive për manifestime kulturore, sportive, ekonomike etj.. Një rol të rëndësishëm në ringjalljen e turizmit në Kosovë mund të luajnë agjencitë turistike, të cilat mund ta zgjerojnë aktivitetin e tyre nga sigurimi i biletave te krijimi i ofertës cilësore turistike.

AKTIVITETI I KONSULENCËS

Nga pikëpamja e zhvillimit të konsulencës në Kosovë, vihet re një ngecje pothuajse totale. Roli i konsulencës shihet i lidhur kryesisht me transfertën teknologjike, progresin teknik vetjak dhe perspektivën eksportuese. Aktiviteti i konsulencës për transfertën teknologjike brenda SME-ve shihet i përqendruar në fazën parainvestive të importit të teknologjisë. Aktiviteti këshillëdhënës në këtë rast, konsiston në grumbullimin e të dhënave përkatëse për prodhuesit e ndryshëm të teknologjive për një varg produktesh që mendohet se do të prodhohen në periudhën e dhënë. Po kështu, ky aktivitet, duke pasur parasysh kërkesat, mund të shtrihet në sferën ekonomike, financiare, juridike. Shërbimet e konsulencës shihen si shumë të dobishme edhe në sferën e marrjes së kredive nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare apo, nga kredidhënësit e jashtëm si edhe në sferën e investimeve të përbashkëta.

INFORMATIKA

Gjenerimi i NVM-ve në fushën e informatikës shihet i lidhur me tregtimin e pajisjeve dhe të *software*-ve, instalimin e tyre, krijimin e *software*-it për qëllime biznesi, krijimin e *software*-it për rrjete, krijimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve dhe arsimimin kompjuterik. Përpilimet e *software*-ve përkatës, specifike për nevojat e segmenteve të ndryshme si edhe mirëmbajtja dhe krijimi i mundësive për aplikimin e tyre, përbëjnë mundësi reale dhe shumë të volitshme për formimin e SME-ve.

TREGTIA

Tregtia në Kosovë ka pasur një zhvillim dinamik i cili është theksuar sidomos gjatë dy viteve të fundit. Pas konfliktit të vitit 1999, Autoriteti Qendror Fiskal që operon në Kosovë pa të arsyeshme vendosjen e një strukture të thjeshtë dhe neutrale të regjimit tregtar. Kjo strukturë u mendua si e përshtatshme për stimulimin e rritjes ekonomike nga ana e sektorit privat,

për shpejtimin e rindërtimit si edhe për krijimin e kushteve për eksporte të shëndetshme. Në mungesën e një makinerie administrative, që do të mund të realizonte mbledhjen e taksave mbi të ardhurat dhe konsumin, UNMIK-u prezantoi regjimin tregtar të bazuar mbi doganat si burimin kryesor të të ardhurave për buxhetin lokal të Kosovës.

Karakteristikat kryesore të regjimit tregtar janë: së pari, prezantimi i një tarife doganore uniforme prej 10 për qind dhe një takse mbi shitjet prej 15 për qind. Kjo strukturë tarifore u rekomandua për shkak të thjeshtësisë dhe të normës së ulët të zbatuar. Njëkohësisht, u paraqitën dhe u vunë në zbatim përjashtime nga taksat doganore të disa produkteve bujqësore dhe mjekësore; së dyti, regjimi i tregtisë së jashtme nuk përfshin masa jotarifore dhe kufizime sasiore; së treti, një përparësi të sistemit e përbëjnë procedurat transparente dhe jodiskriminuese të regjistrimit dhe të licencimit të tregtarëve.

Përsa i përket zhvillimit të tregtisë midis Shqipërisë dhe Kosovës, ai ka marrë hov gjatë dy viteve të fundit duke u materializuar kryesisht në eksportet prej Shqipërisë. Që prej gjashtëmuajorit të dytë të vitit 1999 deri në fund të vitit 2000 Kosova është renditur e katërta ndër partnerët tregtarë të Shqipërisë. Duke pasur parasysh gjendjen jo të rregullt të kufijve doganorë dhe 'urinë' e madhe të tregut kosovar për artikujt bazë të jetës, vlerësohet se eksportet me këtë vend duhet të kenë qenë shumë më të mëdha se shifrat e regjistruara. Mallrat e eksportuar, fillimisht i përkisnin kategorisë së mallrave ushqimorë (drithëra dhe nënprodukte të tyre) ujit të pijshëm, makinerive dhe pajisjeve (kryesisht gjeneratorë elektrikë) dhe produkteve të industrisë së shtypit.

Në fillim të vitit 2000, u vu re një ndryshim i orientimit të këtyre eksporteve. Në përputhje me përmirësimin gradual të kushteve të jetesës dhe të përparësive për rimëkëmbjen e ekonomisë së Kosovës, eksportet e Shqipërisë, krahas mallrave ushqimorë, përqendrohen tashmë në grupin "artikuj të ndryshëm të prodhuar" (pajisje dhome) si edhe në atë të lëndëve djegëse minerale. Fluksi i mallrave në formën e *shuttle trade* vlerësohet

të jetë i konsiderueshëm, gjatë kësaj periudhe. Gjatë vitit 2000, gradualisht, lëndët djegëse dhe produktet e industrisë kimike ia zunë vendin pajisjeve të dhomës të cilat, deri në këtë periudhë, zinin peshën më të madhe të eksporteve shqiptare në Kosovë.

Aktivitetin eksportues e kanë lehtësuar fillimi i funksionimit të linjës ajrore Prishtinë-Tiranë në janar të vitit 2000, hapja e zyrës së INSIG-ut të Shqipërisë në Prishtinë dhe disa panairë tregtare të çelura për nxitjen e këtyre shkëmbimeve. Sidoqoftë, për t'u kthyer në një partner të fuqishëm tregtar të Kosovës, në krahasim me Maqedoninë, Shqipëria paraqet shumë mangësi në aspektin e infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, si edhe të mekanizmave të shëndoshë të marketingut.

Deri më sot Shqipëria është gjendur përballë një situatë jo të favorshme në marrëdhëniet tregtare me Kosovën. Eksportet shqiptare për në Kosovë, përveç vështirësive dhe kostos së lartë të transportit (në mungesë të rrugës Durrës – Kukës), i nënshtrohen një barre të konsiderueshme fiskale. Lidhjet e forta tregtare midis Maqedonisë dhe Kosovës, infrastruktura e rregullt dhe marrëveshja tregtare midis ish-Republikës së Jugosllavisë dhe Maqedonisë, që i siguron kësaj të fundit statusin preferencial në tregti, bëjnë që eksportet nga Shqipëria ta gjejnë me vështirësi rrugën e tyre për në Kosovë. Një zhvillim pozitiv në këtë drejtim përbëjnë përpjekjet e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe të Tregtisë së Shqipërisë, e cila ka filluar bisedimet për nënshkrimin e një Marrëveshjeje të Tregtisë së Lirë me Maqedoninë. Kjo gjë do të zhdukte pengesat doganore për eksportet nga Shqipëria në Maqedoni dhe më pas në Kosovë. Nga ana tjetër, Qeveria e Shqipërisë dhe UNMIK-u nuk kanë hapur asnjëherë bisedime për uljen e pengesave doganore midis dy vendeve. Vështirësitë e përmendura më lart duket se, përveç kostove të larta të atyre tregtarëve që iu nënshtrohen taksave doganore, përbëjnë një shkak të fuqishëm të përhapjes së kontrabandës.

Një tjetër njësi, që po bën përpjekje për forcimin e lidhjeve të biznesit midis tregtarëve të Shqipërisë dhe atyre të Kosovës është Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë. Kjo njësi, në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Kosovës ka

punuar dhe po punon për organizimin e disa takimeve midis palëve të lartpërmendura për krijimin e kushteve për organizimin e panairëve të dyanshme.

SISTEMI BANKAR

Për të siguruar zhvillimin e sistemit bankar në Kosovë UNMIKU-u, në nëntor të vitit 1999, miratoi dy rregullore që përcaktonin themelimin e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës dhe njëkohësisht rregulla për licencimin e bankave tregtare si edhe për kontrollin e mbikëqyrjen e tyre. BPK licencon dhe mbikëqyr të gjitha institucionet financiare banka dhe jobanka, që funksionojnë në Kosovë; mban një stok monedhash dhe kartëmonedhash në marka gjermane dhe dinarë jugosllavë; siguron shërbime depozituese dhe pagesash në marka gjermane deri sa në sistemin tregtar bankar të krijohen kapacitetet e nevojshme. Duke funksionuar si bankë e qeverisë, BPK pranon depozita nga UNMIK-u dhe agjenci të tjera zyrtare dhe bën pagesat me urdhër të Autoritetit Qendror Fiskal dhe të depozituesve të tjerë. Përveç ruajtjes së parasë për arsye sigurie, BPK nuk iu ka ofruar shërbime të depozitave dhe pagesave ndërmarrjeve, me qëllim që të mos kthehet në konkurrence të drejtpërdrejta të sistemit bankar, i cili është në hapat e tij të parë.

Meqenëse në Kosovë nevoja për krijimin e një rrjeti bankar është e madhe, kushtet për krijimin dhe licencimin e bankave të reja vlerësohen të jenë rreth 3-4 herë më pak rigorozë sesa kushtet, që aplikohen në rajon. Procedurat e licencimit parashikojnë një shkallëzim të aktiviteteve që iu lejohen bankave tregtare në përputhje me nivelin e kapitalit. Bankat, që kanë kapital minimal prej 1 milion markash lejohet të pranojnë depozita dhe të ofrojnë shërbim pagesash. Bankat, që duan edhe të japin hua konsumatore apo tregtare, duhet të kenë kapital minimal tre herë më të lartë.

Ndërsa për bankat që duan të zhvillojnë veprimtarinë e administrimit të portofolit, të tregtimit të letrave me vlerë të

borxhit apo pronësisë kërkohet të kenë kapital 5 milionë marka gjermane.

Aktualisht, në Kosovë funksionojnë tre banka tregtare dhe 10 institucione financiare jobankare të licencuara. Bankat tregtare merren kryesisht me pranimin e depozitave dhe kryerjen e transfertave bankare, ndërkohë që aktiviteti kreditues lëvrohet shumë pak ose aspak. Rolin kreditues momentalisht e luajnë institucionet e lartpërmendura (që varen nga Banka Botërore, BERZH, EAR etj.) të cilat japin kredi me synim uljen e interesave. Disa prej këtyre fondacioneve japin kredi me interesa në nivelin 7-12 për qind, ndërkohë që paralelisht po punohet për krijimin e kushteve për ofrimin e kredive të vogla (2000 – 5000 marka gjermane ose 1000 – 2500 dollarë amerikanë) për sipërmarrjet bujqësore. Në këtë mënyrë, duket se po krijohet një ambient deri-diku nxitës, si edhe parakushtet për një treg të mirëfilltë financiar.

Një përkrahjetjetër që i bëhet rajonit në përgjithësi dhe Kosovës në veçanti, vjen nga Pakti i Stabilitetit, i cili u adoptua në qershor 1999. Në kuadër të këtij pakti synohet të përballohen problemet urgjente që lindën nga kriza në Kosovë, për t'u përqendruar më vonë në nxitjen e zhvillimit dhe të stabilitetit në të gjithë Evropën Juglindore. Me gjithë mangësitë dhe problemet që mbart në vetvete, vëmendja që i është kushtuar dhe po i kushtohet rajonit nga organizata të fuqishme ndërkombëtare duhet vlerësuar dhe shfrytëzuar në kohë.

PËRFUNDIME

Paraqitja e mësipërme transmeton mesazhe kontradiktore, të cilat nga njëra anë nxjerrin në pah realitetin jo shumë optimist të ekonomisë dhe të investimeve në Kosovë, dhe nga ana tjetër synojnë të ngjallin interesin e investitorëve apo të tregtarëve për shfrytëzimin e mundësive dhe sidomos të kërkesave të mëdha të vendit në fusha të ndryshme të ekonomisë. Në këto kushte, është e vështirë të zbehësh apo të mbulosh problemet e shumta që rrjedhin nga statusi aktual politik i Kosovës dhe nga goditja

fatale që pësoi vendi në vitin 1999. Sidoqoftë duket se ka ardhur koha që situata të shihet me një sy më pak pesimist dhe të pranohet që Kosova ka shpresë dhe mundësi për ta realizuar atë.

Ekonomia e tregut është një gjë dhe motivet morale apo politike, diçka tjetër. Nisur nga këndvështrimi thjesht ekonomik mund të thuhet që shpeshherë duhet pak guxim dhe iniciativë për të hedhur sytë atje ku rrallëkush guxon të shkojë, por ku mundësitë për fitim janë të shumta. Këndvështrimi tjetër, që në këtë rast mund të përkthehej, integrim i Shqipërisë dhe i Kosovës nëpërmjet ekonomisë apo disa prej degëve të saj, mbetet për t'u vënë në provë, gjithnjë pasi të jetë dëshmuar se veprimi në bazë të interesit vetjak të të gjitha palëve, ka dhënë frytet e veta.

SHËNIME

* Selami Xhepa, Diana Shtylla, specialistë, Departamenti i Kërkimeve.

¹ Në kohën e këtij shkrimi, nuk ekziston asnjë raport ekonomik dhe tregues të zhvillimeve apo episode të ndonjë situatë të rënduar ekonomike në këtë vend. Nga ana tjetër, edhe të dhënat mbi zhvillimet e brendshme ekonomike nuk janë disponibël. Aktualisht, nuk disponojmë të dhëna mbi zhvillimet tregtare, të buxhetit, të turizmit, të tranzitimit etj.. Për rrjedhojë, të paktën deri sot, do të ishte e vështirë të bënim një analizë të saktë vlerësuese të ndikimeve të mundshme.

² Fjalimi i Guvernatorit të Bankës Kombëtare të Maqedonisë në Parlament, shkurt 2001.

³ South-East Europe, EIS, shkurt, 2001.

⁴ Shih. Bishev "Monetary Policy in the Balkan Region", WP, NBRM.

⁵ Gjatë vitit që kaloi financat publike rezultuan me suficit që rezultoi kryesisht nga shitjet e paketave të aksioneve të Telekomit (51 për qind të aksioneve u shitën për 342 milionë euro në cash dhe 256 milionë euro investime kompanisë Hungareze Matav). Shih. South-East Europe, EIS, shkurt, 2001.

⁶ "The Guardian", prill 2001.

⁷ Mbyllja e kufirit mund të ketë patur më shumë ndikim në ekonominë e Kosovës pasi tranzitimi i mallrave për në Kosovë kryhej nëpërmjet Maqedonisë, kjo për shkak të mosekzistencës së barrierave doganore mes tyre, ndërsa në rastin e tranzitimit nëpërmjet kufirit nga Kukësi, zbatohet një tarifë doganore prej 20 për qind. Këto ndryshime në sistemin e tranzitimit, mund të kenë dhënë efekte dhe në ndryshimet në kanalet e furnizimit me mallra të zonës verilindore të vendit tonë (nga importet nga Kosova, për shkak të çmimeve më të ulëta) në furnizimin e tyre nga Tirana. Shih. "Shekulli", 27 mars 2001.

BIBLIOGRAFI

Departamenti për tregti dhe industri, Broshurë.

Kosova, Republika Federale e Jugosllavisë, Reformat sociale dhe ekonomike për paqe dhe pajtim, Raporti Nr.21784-Kos, Banka Botërore, Shkurt 2001.

Ish-bankat e Jugosllavisë iu kanë borxh kosovarëve mbi 200 milionë dollarë, Gazeta "Ekonomia", 17 Prill 2001.

Kosova: Çështjet makroekonomike dhe qëndrueshmëria fiskale, Corker, R., Kostial, K., Rehm, D., FMN 2001.

Kosova - ekonomia astmatike pas luftës, "Monitor" Nr. 8, Mars 2001.

Maqedonia rrit çmimet në Kosovë, Gazeta "Ekonomia", 27 Mars 2001.

Shqipëri – Kosovë: Integrimi përmes ekonomisë, "Monitor" Nr. 4, Mars 2001.

<http://www.kosova.com/RIINVEST/riinvest.htm>, Instituti për Kërkimet e Zhvillimit, Kosovë.

